

shtator 2026

Raporti monitorues i keqinformimit për muajin gusht

2026

Action for
Democratic Society
hibrid.info



Raporti monitorues i keqinformimit për muajin gusht

Publikues: ADS/hibrid.info

Prishtinë, shtator 2026

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga ADS/hibrid.info. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe me Ligjin Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të bartet, në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, qoftë mekanik, me fotokopje, incizim apo në mënyra të tjera, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit

Ky raport është publikuar nga Action for Democratic Society (ADS), dhe përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e ADS-së.

Projekti realizohet nga:



Përmbajtja

01.

Publikimet në gjuhën shqipe

Kategoritë vlerësuese të çrregullimit informativ
Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese
Llojet e fushave tematike
Llojet e publikuesve
Klasifikimi i publikimeve të mediave në gjuhën shqipe dhe serbe
Llojet e mediave sociale
Figurat dhe Institucionet më të përfolura

02.

Publikimet në gjuhën serbe (e tjera)

Kategoritë vlerësuese të çrregullimit informativ
Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese
Llojet e fushave tematike
Llojet e publikuesve
Klasifikimi i publikimeve të mediave në gjuhën shqipe dhe serbe
Llojet e mediave sociale
Figurat dhe Institucionet më të përfolura

03.

Narrativat ruso-serbe

Hyrje

Ky raport përmbledhës dhe përshkrues pasqyron gjendjen e informimit (keqinformimit) gjatë gushtit 2026, bazuar në të dhënat e siguruara nga platforma për kontroll të fakteve – hibrid.info. Format i këtij raporti është i pari dhe i vetmi i llojit. Është monitorues dhe paraqet gjendjen për një periudhë njëmuajore, ndërsa ky është raporti i 50-të mujor i publikuar deri më tash.

Ky raport është i ideuar nga platforma hibrid.info e specializuar në kontroll të fakteve, edukim digjital dhe medial, pjesë e OJQ-së kosovare “Action for Democratic Society” (ADS).

Në këtë raport monitorues jepet një pasqyrë për formën e përmbajtjeve me karakter informues për dhe rreth ngjarjeve në Kosovë. Në vazhden e këtij raporti paraqiten disa figura (grafika) të dala nga baza e të dhënave të hibrid.info e ndarë përmes disa kategorive të vlerësimit që janë pjesë e metodologjisë për kontroll të fakteve të kësaj platforme.

Raporti trajton 8 kategori krahasuese të të dhënave, duke synuar të japë një sqarim më objektiv të gjendjes së informimit dhe për të shpjeguar tendencat e keqinformimit për këtë periudhë monitoruese.

Kategoritë monitoruese janë:


- Vlerësimet e artikujve keqinformues;
- Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese;
- Fushat mbi të cilat janë krijuar dhe shpërndarë artikujt keqinformues;
- Llojet e mediave që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Kategorizimi i mediave në gjuhën shqipe dhe serbe që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Llojet e mediave sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Llojet e publikuesve në mediat sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Institucionet dhe personat e përfolur në artikujt keqinformues;
- Kontrolli dhe vlerësimi i deklaratave.

Përmbajtja e trajtuar nga hulumtuesit e hibrid.info, e që ka shërbyer për ndërtimin e këtij raporti, është kryesisht ajo e publikuar në gjuhën shqipe dhe serbe.

Klasifikimi i publikimeve në gjuhën shqipe dhe serbe (të tjera)

Kjo matje tregon se në cilën gjuhë janë publikuar artikujt keqinformues të monitoruar gjatë periudhës njëmuajore, duke i kategorizuar mediat në gjuhën shqipe, serbe dhe gjuhë të tjera në lidhje me raportimet e tyre për dhe rreth zhvillimeve në Kosovë.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË GJUHËN SHQIPE DHE SERBE



Mostra e monitorimit dhe trajtimit të përmbajtjeve keqinformuese nga platforma “hibrid.info” fokusohet në keqinformimet në gjuhën shqipe, të publikuara në media tradicionale, portale të dyshimta, si dhe në faqe apo llogari në rrjetet sociale. Ajo përfshin gjithashtu klasifikimin e publikimeve edhe në gjuhë të tjera (si serbisht dhe anglisht).

Gjatë muajit gusht 2026, monitorimi identifikoi gjithsej 40 raste të përmbajtjeve keqinformuese. Shumica dërrmuese e tyre, 35 raste ose 87%, u publikuan në gjuhën shqipe, ndërsa 5 raste ose 13% u evidentuan në gjuhën serbe.

Publikimet në gjuhën shqipe

Përmbajtjet keqinformuese të publikuara në gjuhën shqipe dominuan edhe gjatë muajit gusht 2026, me 35 nga gjithsej 40 rastet e identifikuar, që përbëjnë 87% të numrit të përgjithshëm të rasteve të evidentuara.

Keqinformimi u karakterizua nga dominimi i lajmeve të rreme (37%), të pasuara nga manipulimi i fakteve (20%) dhe clickbait-i (17%). Përmbajtjet e paverifikuara dhe mashtrimet përbënin nga 11% secila, ndërsa dezinformatat 3%. Në aspektin tematik, dominuan deklaratat e rreme (31%), të ndjekura nga Gjykata Speciale (9%) dhe shtesat për fëmijë (6%), ndërsa temat e tjera, si zgjedhjet, zhvillimet në veri, energjia, pensionet, Ura e Ibrit, incidentet dhe çështjet rajonale, u shfaqën me nga 3%. Politika ishte fusha dominuese me 69%, ndërsa pas saj renditeshin fusha sociale me 9%, siguria dhe drejtësia me nga 6%, si dhe kronika e zezë, energjetika, komunikacioni dhe siguria kibernetike me nga 3%.

Për sa i përket kanaleve të shpërndarjes, 94% e rasteve u publikuan në media sociale, ndërsa vetëm 6% në media. Facebook-u dominoi me 88% të rasteve, i ndjekur nga TikTok-u me 9% dhe platformat e tjera me 3%. Kjo tregon një mbizotërim të qartë të rrjeteve sociale, veçanërisht Facebook-ut, në qarkullimin e përmbajtjeve keqinformuese gjatë gushtit. Përmbajtjet e identifikuar në këto platforma u karakterizuan kryesisht nga lajme të rreme, manipulim i fakteve, clickbait dhe përmbajtje të paverifikuara, duke prekur kryesisht zhvillimet politike dhe institucionale, por edhe çështje sociale, të sigurisë, drejtësisë dhe energjetikës.


Përqindja e përmbajtjeve në
gjuhën shqipe



Kategoritë vlerësuese të çrregullimit informativ


KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas kategorive vlerësuese



Gjatë muajit gusht 2026, rastet e keqinformimit të identifikuar gjatë monitorimit u karakterizuan nga një dominim i lajmeve të rreme, të cilat përbënin 37% të rasteve të evidentuara. Në vendin e dytë u renditën rastet e manipulimit të fakteve, me 20%, të pasuara nga përmbajtjet clickbait, me 17%. Ndërkohë, përmbajtjet e paverifikuara dhe mashtrimet përbënin nga 11% secila, duke dëshmuar praninë e konsiderueshme të përmbajtjeve që synojnë të tërheqin vëmendjen, të shtrembërojnë informacionin ose të nxisin reagime të shpejta të audiencës. Dezinformatat përbënin 3% të rasteve të identifikuar, duke qenë kategoria me përqindjen më të ulët gjatë këtij muaji.

Në krahasim me korrikun 2026, kur clickbait-i dominonte me 43% të rasteve të identifikuar, në gusht vërehet një ndryshim i dukshëm në strukturën e përmbajtjeve keqinformuese. Në gusht, lajmet e rreme u renditën në vendin e parë me 37%, ndërsa clickbait-i ra në 17%, duke shënuar një rënie prej 26 pikë përqindjeje. Në të njëjtën kohë, manipulimi i fakteve u rrit nga 10% në korrik në 20% në gusht, ndërsa përmbajtjet e paverifikuara u rritën nga 5% në 11%. Mashtrimet mbetën relativisht të qëndrueshme, me një rritje të lehtë nga 10% në 11%. Ndërkaq, kategoritë e kombinuara të korrikut, si “Manipulim i fakteve/Clickbait” dhe “Manipulim i fakteve/Dezinformatë”, me nga 5% secila, nuk u evidentuan si kategori të veçanta në të dhënat e gushtit.



Nga 37% e artikujve keqinformues të trajtuar kanë marrë vlerësimin “lajm i rremë”.

1.1.1. Analizë e llojeve të vlerësimeve

01. Lajm i rremë

Kategoria “Lajm i rremë” përbënte 37% të të gjitha rasteve të keqinformimit të identifikuar dhe ishte kategoria më e pranishme gjatë këtij muaji. Të gjitha rastet e kësaj kategorie lidhen me fushën e politikës dhe u publikuan në media sociale, kryesisht në Facebook dhe TikTok. Pjesa më e madhe e tyre, 29%, përbëhej nga deklaratat të rreme të atribuara politikanëve, figurave publike dhe personaliteteve ndërkombëtare, ndërsa raste të tjera lidhen me protestat në Shqipëri (3%), sondazhe të rreme politike në Kosovë (3%) dhe pretendime të rreme që ndërlidhen me Urën e Ibrit (3%). Në mesin e deklaratave të sajura u evidentuan pretendime që u atribuonin deklaratat të rreme Hashim Thaçit, Albin Kurtit, Wolfgang Petritschit, Janusz Bugajskit, Azem Vllasit, Arsim Bajramit, Hillary Clintonit, Eliot Engelit, Hakan Fidanit, Rifat Jasharit dhe Edi Ramës, ndërsa një tjetër rast përfshinte një deklaratë të rreme që i atribuohet presidentit kroat Zoran Milanović. Këto raste karakterizohen kryesisht nga përdorimi i figurave publike për të krijuar deklaratat të paqena, shpesh duke i paraqitur ato përmes imazheve ose formateve që krijojnë përshtypjen se bëhet fjalë për citime apo raportime të mediave kredibile.

02. Manipulim i fakteve

Manipulimi i fakteve përbënte 20% të rasteve të keqinformimit të identifikuar. Shumica e këtyre përmbajtjeve, 17%, u publikuan në media sociale, ndërsa 3% u publikuan përmes mediave. Për nga fusha, dominuan rastet që lidhen me politikën, me 14% të rasteve, ndërsa pjesa tjetër u shpërnda në tema si drejtësia, siguria kibernetike, krijimi i institucioneve, shqiptarët në Serbi, varrezat masive dhe zgjedhjet e reja. Ndër rastet e evidentuara ishin keqinterpretimi i deklaratave të Richard Grenellit për zgjedhjet në Kosovë dhe kthimin e Hashim Thaçit, pretendimi i pabazuar për një varrezë masive në hapësinën e Universitetit të Prishtinës, si dhe paraqitja e një projektligji në Kongresin amerikan si të miratuar, ndonëse ai ende nuk kishte përfunduar procesin legjislativ. Po ashtu, u evidentuan keqinterpretime lidhur me qëndrimet e Bedri Hamzës për krijimin e institucioneve, ngatërrimi i Gjykatës Penale Ndërkombëtare (ICC) me Dhomat e Specializuara të Kosovës, si dhe pretendimi i ekzagjeruar se Shqipëria është shteti me sigurinë më të lartë kibernetike në botë bazuar në renditjen e NCSI-së.


03. Clickbait

Përmbajtjet e kategorisë “Clickbait” përbënin 17% të rasteve të keqinformimit të identifikuara. Shumica e tyre, 14%, u publikuan në media sociale, ndërsa 3% në media. Për nga fushat, dominuan temat sociale, me 9%, ndërsa drejtësia, kronika e zezë dhe politika përbënin nga 3% secila. Sa i përket tematikave specifike, shtesat për fëmijë ishin më të pranishmet, me 6%, të pasuara nga rastet që lidhen me Gjykatën Speciale, luksin institucional, raste tragjike dhe rritjen e pensioneve, me nga 3% secila. Ndër rastet e evidentuara u identifikuan tituj që krijojnë përshtypje të rreme ose të ekzagjeruar, si pretendimi se ishin ndaluar shtesat prej 30 eurosh për të gjithë fëmijët, paraqitja e një tenderi për 104 automjete si blerje vetëm nga Qeveria, si dhe publikimi i lajmit për rritjen e pensioneve në Kroaci pa e specifikuar qartë vendin. Po ashtu, u evidentua përdorimi i titujve alarmues për raste tragjike jashtë Kosovës dhe për një “lirim” të mundshëm të Hashim Thaçit, duke paraqitur pretendime ose informacione të pjesshme si ngjarje të sigurta.

04. Përmbajtje e paverifikuar

Përmbajtjet e paverifikuara përbënin 11% të rasteve të keqinformimit të identifikuara. Të gjitha këto raste u publikuan në media sociale dhe u shpërndanë në fusha të ndryshme, me politikën si fushën dominuese me 6%, ndërsa komunikacioni dhe siguria përbënin nga 3%. Për nga temat, rastet u ndanë në aksidente, deklarata të rreme, pretendime lidhur me postin e presidentit dhe zhvillime në veri, me nga 3% secila. Përmbajtjet e evidentuara përfshinin raste ku mungesa e informacionit të plotë ose e burimeve të verifikueshme mund të çonte në keqinterpretim, përfshirë pretendime për ngjarje të rënda, deklarata të atribuara figurave publike dhe informacione lidhur me zhvillimet politike e të sigurisë. Në disa raste, përmbajtjet përdornin tituj ose përshkrime që nuk jepnin kontekst të mjaftueshëm për ngjarjen, duke e bërë të vështirë për audiencën të kuptojë saktë se ku, kur dhe në çfarë rrethanash kishte ndodhur ajo.

1.2. Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese



Gjatë muajit gusht 2026, temat e keqinformimit u dominuan dukshëm nga deklaratat e rreme, të cilat përbënin 31% të rasteve të identifikuara. Pas tyre renditej Gjykata Speciale, me 9%, ndërsa shtesat për fëmijë përbënin 6%. Temat e tjera ishin më të shpërndara, me nga 3% secila, dhe përfshinin zgjedhjet e reja, Trumpin dhe Kosovën, sigurinë kibernetike në Shqipëri, krijimin e institucioneve, varrezat masive, raportimet për Kurtin dhe Millosheviqin, aksidentet, shqiptarët në Serbi, incidentin në Kuvend, sondazhet e rreme, luksin institucional, Time Kadrijajn dhe Skender Llugiqin, postin e presidentit, Urën e Ibrit, protestat në Shqipëri, zhvillimet në veri, rastet tragjike, reduktimet e energjisë elektrike dhe rritjen e pensioneve. Kjo shpërndarje tregon se, përveç deklaratave të rreme dhe temave që lidhen me zhvillimet politike e institucionale, keqinformimi gjatë gushtit preku edhe çështje sociale, të sigurisë, energjisë dhe zhvillimeve rajonale.

Në krahasim me korrikun 2026, kur temat e keqinformimit ishin më të përqendruara në disa çështje specifike, gushti shënoi një shpërndarje më të gjerë tematike. Në korrik, tema dominuese ishte Kosova dhe NATO, me 14%, ndërsa Qumështorja Vita, rastet tragjike, Gjykata Speciale dhe zgjedhja e presidentit përbënin nga 10% secila. Në gusht, ndërkaq, deklaratat e rreme u bënë tema kryesore, me 31%, të ndjekura nga Gjykata Speciale (9%) dhe shtesat për fëmijë (6%). Disa tema të pranishme në korrik, si Gjykata Speciale, rastet tragjike, protestat në Shqipëri dhe Trumpi dhe Kosova, vazhduan të shfaqen edhe në gusht, por me peshë më të ulët ose të ngjashme. Në të njëjtën kohë, në gusht u shfaqën një numër më i madh temash të reja, përfshirë zgjedhjet e reja, krijimin e institucioneve, varrezat masive, shqiptarët në Serbi, Urën e Ibrit, zhvillimet në veri, reduktimet e rrymës dhe rritjen e pensioneve.

Analizë e kontrolleve të fakteve sipas temave

1.2.1.

Në vijim analizohen, në formë të përmbledhur, katër temat kryesore të trajtuara, që u publikuan nga media dhe publikues të ndryshëm, sipas matjeve të platformës hibrid.info, përmes metodologjisë së kontrollit të fakteve.

01. Deklarata të rreme

Deklaratat e rreme përbënin 31% të të gjitha temave të keqinformimit të identifikuar, duke qenë tema dominuese e muajit. Pothuajse të gjitha këto raste, 29%, u klasifikuan si “Lajm i rremë”, ndërsa 3% si “Përmbajtje e paverifikuar”. Të gjitha rastet lidhen me fushën e politikës dhe u publikuan në media sociale, kryesisht përmes Facebook-ut dhe TikTok-ut. Në përmbajtjet e verifikuara u evidentua një prirje e theksuar për t’u atribuar deklarata të paqena ose të pasakta figurave politike dhe publike, përfshirë Albin Kurtin, Hashim Thaçin, Pandeli Majkon, Janusz Bugajskin, Rifat Jasharin, Wolfgang Petritschin, Hillary Clintonin, Eliot Engelin, Azem Vllasin dhe Arsim Bajramin. Në disa raste, deklaratat ishin tërësisht të sajura, ndërsa në raste të tjera deklarata reale ishin nxjerrë jashtë kontekstit ose paraqitur si aktuale, siç ishte rasti i deklaratës së Pandeli Majkos të vitit 2023. Këto përmbajtje shpesh shoqëroheshin me imazhe ose formate që krijojnë përshtypjen e citimeve autentike, pa ofruar burim të verifikueshëm, intervistë apo dëshmi të besueshme.

02. Gjykata speciale

Tema e Gjykatës Speciale përbënte 9% të rasteve të keqinformimit të identifikuar. Nga këto, 6% u klasifikuan si “Manipulim i fakteve”, ndërsa 3% si “Clickbait”. Shumica e rasteve, 6%, lidhej me fushën e drejtësisë, ndërsa 3% me politikën, dhe të gjitha u publikuan në media sociale. Përmbajtjet e evidentuara lidhen kryesisht me procesin ndaj Hashim Thaçit dhe interpretimin e deklaratave politike rreth Gjykatës Speciale. Ndër rastet e verifikuara ishte pretendimi se Donald Trump dhe Marco Rubio kishin sulmuar Gjykatën Speciale në Hagë dhe kishin paralajmëruar shkatërrimin e saj, ndonëse deklaratat e tyre i referoheshin Gjykatës Penale Ndërkombëtare (ICC), e cila është institucion tjetër nga Dhomat e Specializuara të Kosovës. Gjithashtu, një titull clickbait e paraqiste lirim të Hashim Thaçit si të sigurt, ndërsa një video tjetër përdorte në mënyrë të shkëputur një deklaratë të Albin Kurtit nga viti 2014, duke ndryshuar kuptimin e saj përmes heqjes së kontekstit.

03. Shtesat për fëmijë

Gjatë muajit gusht 2026, tema e shtesave për fëmijë përbënte 6% të rasteve të keqinformimit të identifikuar. Të gjitha rastet u klasifikuan në kategorinë “Clickbait”, i përkisnin fushës sociale dhe u publikuan në media sociale. Përmbajtjet e evidentuara krijojnë përshtypjen se shtesat prej 30 eurosh për fëmijët ishin ndërprerë për të gjithë përfituesit, ndërsa verifikimi tregoi se bëhej fjalë për procesin e verifikimit të përfituesve dhe mundësinë e largimit nga skema vetëm të familjeve që nuk i plotësojnë kriteret. Në këtë mënyrë, informacioni i publikuar ishte paraqitur përmes titujve çorientues dhe pa kontekst të mjaftueshëm, duke mundësuar keqinterpretimin e situatës reale nga audienca.


04. Veriu

Gjatë muajit gusht 2026, tema e veriut të Kosovës përbënte 3% të rasteve të keqinformimit të identifikuar. Ky rast u klasifikua si “Përmbajtje e paverifikuar”, i përkiste fushës së sigurisë dhe u publikua në media sociale. Bëhej fjalë për një video të publikuar nga faqet e mediave në Facebook, e cila pretendonte se aeroplanë luftarakë serbë po fluturonin mbi Jarinjë. Megjithatë, verifikimi i kryer nga Hibrid.info, përmes mjetit InVID, tregoi se pamjet nuk ishin të kohëve të fundit, por ishin publikuar fillimisht në vitin 2021. Rasti ilustron përdorimin e materialeve të vjetra si përmbajtje aktuale, duke krijuar një perceptim të rremë mbi zhvillimet e sigurisë në veri të Kosovës.

1.3. Llojet e fushave

Në korrik, politika qëndroi si tema kryesore e keqinformimit, duke përbërë 69% të të gjitha rasteve të analizuara. Kjo rritje lidhej kryesisht me deklaratat e rreme politike të cilat u përdorën për të dezinformuar gjatë kësaj periudhe.

FUSHAT KRYESORE
Këtu janë renditur 6-të fushat kryesore



Gjatë muajit gusht 2026, keqinformimi i identifikuar gjatë monitorimit u përqendrua kryesisht në fushën e politikës, e cila përbënte 69% të rasteve të evidentuara. Pas saj renditej fusha sociale me 9%, ndërsa siguria dhe drejtësia përbënin nga 6% secila. Fushat e tjera kishin një përfaqësim më të ulët, me nga 3%: kronika e zezë, energjetika, komunikacioni dhe siguria kibernetike. Kjo shpërndarje tregon se, gjatë gushtit, keqinformimi ishte i orientuar në masë të madhe drejt zhvillimeve dhe figurave politike, ndërsa temat sociale, të sigurisë dhe drejtësisë përbënin pjesën tjetër të rasteve të monitoruara.

Në krahasim me korrikun 2026, fusha e politikës shënoi një rritje të konsiderueshme të peshës në rastet e keqinformimit, nga 38% në 69%, pra me 31 pikë përqindjeje. Ndërkohë, siguria, e cila në korrik përbënte 19%, ra në 6% në gusht. Edhe sundimi i ligjit, me 10% në korrik, nuk u evidentua si kategori e veçantë në gusht, ndërsa kronika e zezë u ul nga 10% në 3%. Drejtësia gjithashtu ra nga 10% në 6%. Nga ana tjetër, energjetika mbeti në të njëjtin nivel prej 3%, ndërsa në gusht u shfaqën si fusha të reja socialja (9%), komunikacioni (3%) dhe siguria kibernetike (3%). Po ashtu, temat e sportit (5%) dhe shëndetësisë (5%), të evidentuara në korrik, nuk u regjistruan si fusha të veçanta në gusht.




69% e përmbajtjeve keqinformuese të trajtuara janë nga fusha e politikës.

1.4. Llojet e publikuesve

Gjatë muajit gusht 2026, shumica dërrmuese e rasteve të keqinformimit u publikuan në media sociale, të cilat përbënin 94% të rasteve të identifikuar. Ndërkohë, vetëm 6% e përmbajtjeve keqinformuese u publikuan përmes mediave. Kjo shpërndarje tregon se media sociale vazhdojnë të jenë kanali kryesor i përhapjes së përmbajtjeve keqinformuese, duke pasur një dominim të theksuar në krahasim me mediat tradicionale dhe online.

Në krahasim me korrikun 2026, kur shpërndarja e rasteve të keqinformimit ishte pothuajse e barabartë mes mediave sociale (52%) dhe mediave (48%), në gusht u vërejt një ndryshim i theksuar në kanalet e publikimit. Në gusht, mediat sociale përbënin 94% të rasteve, duke shënuar një rritje prej 42 pikë përqindjeje, ndërsa përmbajtjet e publikuara në media ranë nga 48% në 6%, pra me 42 pikë përqindjeje. Kjo tregon një zhvendosje të fuqishme të përhapjes së keqinformimit drejt platformave sociale, të cilat gjatë gushtit u bënë kanali pothuajse ekskluziv i publikimit të rasteve të identifikuar.

DALLIMI NË PËRQINDJE NË MES
TË PUBLIKUESVE ME
PËRMBAJTJE KEQINFORMUESE



94% e artikujve me përmbajtje keqinformuese janë publikuar nga publikuesit në media sociale


Llojet e mediave sociale

Në këtë seksion analizohen vetëm artikujt keqinformues të publikuar dhe shpërndarë nga publikuesit në mediat sociale dhe në këtë rast nuk përfshihen publikimet në mediat tjera (mediat reale dhe portalet e dyshimta).

Gjatë muajit gusht 2026, Facebook-u ishte platforma kryesore për publikimin e përmbajtjeve keqinformuese në media sociale, duke përbërë 88% të rasteve të identifikuara. TikTok-u renditej i dyti me 9%, ndërsa 3% e rasteve u publikuan në platforma të tjera sociale. Kjo shpërndarje tregon një dominim të theksuar të Facebook-ut në përhapjen e përmbajtjeve keqinformuese gjatë këtij muaji.

Në krahasim me korrikun 2026, kur Facebook-u përbënte 64% dhe TikTok-u 36% të rasteve të keqinformimit të publikuara në media sociale, në gusht u vu re një rritje e dukshme e dominimit të Facebook-ut. Facebook-u u rrit nga 64% në 88%, ose 24 pikë përqindjeje, ndërsa TikTok-u ra nga 36% në 9%, ose 27 pikë përqindjeje. Kjo tregon se gjatë gushtit Facebook-u u konsolidua edhe më shumë si platforma kryesore për përhapjen e përmbajtjeve keqinformuese, ndërsa prania e TikTok-ut u zvogëlua ndjeshëm krahasuar me muajin paraprak.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË
MEDIAT SOCIALE




1.6.

Llojet e publikuesve në mediat sociale

Kjo matje, përmes të dhënave monitoruese, analizon ndërveprimin në mediat sociale sa i përket publikimit dhe shpërndarjes së artikujve keqinformues nga publikues të ndryshëm të mediave sociale. Kjo bëhet përmes këtyre kategorive kryesore të publikuesve: faqeve, llogarive, mediave dhe kanaleve që menaxhohen nga përdorues të mediave sociale.

Gjatë muajit gusht 2026, Facebook-u dominoi si platforma kryesore e publikimit të përmbajtjeve keqinformuese, me 88% të rasteve. Brenda kësaj platforme, faqet (fan pages) përbënin 48%, llogaritë individuale 27%, ndërsa mediat 12%. TikTok-u përbënte 9% të rasteve, ku 9% u publikuan nga llogari. Ndërkohë, YouTube përbënte 3%, me rastet e evidentuara të publikuara nga media. Në përgjithësi, të dhënat tregojnë se faqet dhe llogaritë në Facebook ishin burimet kryesore të përmbajtjeve keqinformuese, duke përbërë së bashku 75% të rasteve të monitoruara.



Analiza e llojeve të publikuesve në mediat sociale

Në vijim analizohen këto kategori të mediave sociale në ndërlidhje me publikimet dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

01. Facebook

Gjatë muajit gusht 2026, Facebook-u përbënte 88% të rasteve të keqinformimit të identifikuar në media sociale. Brenda përmbajtjeve të publikuara në këtë platformë, dominuan lajmet e rreme, me 33%, të pasuara nga manipulimi i fakteve (18%), përmbajtjet e paverifikuara (12%) dhe clickbait-i (12%), ndërsa mashtrimet përbënin 9% dhe dezinformatat 3%. Sa i përket temave, deklaratat e rreme ishin më të pranishmet, me 30%, ndërsa shtesat për fëmijë dhe Gjykata Speciale përbënin nga 6% secila. Temat e tjera, përfshirë varrezat masive, Trumpin dhe Kosovën, rritjen e pensioneve, zgjedhjet e reja, krijimin e institucioneve, shqiptarët në Serbi, Kurtin dhe Millosheviqin, Time Kadrijajn dhe Skender Llugiqin, postin e presidentit, Urën e Ibrit, protestat në Shqipëri, veriun, rastet tragjike, aksidentet dhe reduktimet e rrymës, përbënin nga 3% secila. Për nga fushat, politika dominonte dukshëm me 61%, e ndjekur nga çështjet sociale (9%) dhe siguria (6%), ndërsa energjetika, drejtësia, komunikacioni dhe kronika e zezë përbënin nga 3% secila.


02. Tiktok

TikTok-u përbënte 9% të rasteve të keqinformimit të identifikuar në media sociale. Prej tyre, 6% u klasifikuan si “Lajm i rremë”, ndërsa 3% si “Mashttrim”. Të gjitha rastet i përkisnin fushës së politikës dhe lidhen me tema si deklaratat e rreme, sondazhet e rreme dhe incidentet në Kuvend, me nga 3% secila. Ndër rastet e verifikuara ishte një sondazh i rremë politik, i paraqitur si matje e realizuar me 1,500 respondentë, për të cilin nuk u gjetën të dhëna mbi realizuesin apo publikim në burime kredibile. Po ashtu, një tjetër pretendim i rremë i atribuonte ish-kongresmenit amerikan Eliot Engel një deklaratë për lirin e Hashim Thaçit, pa u gjetur dëshmi në burime të besueshme. Në një rast tjetër u identifikua një ballinë e falsifikuar e gazetës serbe “Blic”, e cila përdorte emrin, logon dhe elementet grafike të mediumit real për të krijuar përshtypjen e autenticitetit; verifikimi tregoi se ballina ishte gjeneruar me inteligjencë artificiale.

Figurat dhe institucionet më të përfolura

Kjo matje analizon të dhënat se cilat kanë qenë institucionet dhe personalitetet (figura publike e politike) më të përfolura përmes monitorimit të artikujve me përmbajtje keqinformuese.

RENDITJA E INSTITUCIONEVE
MË TË PËRFOJLURA SIPAS
PËRQINDJES




Gjatë muajit gusht 2026, në tri raste të keqinformimit u përfshinë drejtpërdrejt institucione ose subjekte publike, me nga 33% për secilin rast.

Një rast lidhej me KEDS-in, të cilit në mënyrë të rreme iu atribuua njoftimi për reduktim të përgjithshme të energjisë elektrike në gjithë Kosovën me orar “4:2”, ndërsa në fakt njoftimet zyrtare kishin të bënin vetëm me ndërprerje të planifikuara në zona të caktuara.

Një tjetër rast përfshinte LVV-në, PDK-në, LDK-në dhe AAK-në, përmes publikimit të një sondazhi të pakredibil që pretendonte se paraqiste mbështetjen për këto subjekte politike.

Rasti i tretë lidhej me Qeverinë, ku një titull krijonte përshtypjen se ajo do të blinte e vetme 104 vetura në vlerë prej 2.4 milionë eurosh, ndonëse dokumentet e tenderit tregonin se kontrata përfshinte edhe institucione të tjera publike.

RENDITJA E PERSONAVE MË TË PËRFOLUR SIPAS PËRQINDJES



Gjatë muajit gusht 2026, personalitete publike u përfshinë në 22 përmbajtje keqinformuese, ndërsa figura më e përfolur ishte Albin Kurti, i cili u shfaq i vetëm në 14% të rasteve dhe në kombinim me personalitete të tjera në raste të tjera të evidentuara.

Në përmbajtjet ku Kurti u përfshi bashkë me figura të tjera, ai u ndërlidh me Arsim Bajramin, Azem Vllasin, Hashim Thaçin, Hillary Clintonin, Janusz Bugajskin, Pandeli Majkon, Slobodan Millosheviqin, Time Kadriajin, Wolfgang Petritschin dhe Zoran Milanoviqin, me nga 5% secila. Personalitete të tjera të përfshira në përmbajtjet keqinformuese ishin Aleksandar Vuçiq dhe Hakan Fidan, Donald Trump dhe Marco Rubio, si dhe Edi Rama, Hashim Thaçi, Eliot Engel, Richard Grenell, Rifat Jashari dhe Skender Llugiqi. Në përgjithësi, të dhënat tregojnë se Albin Kurti ishte figura qendrore në këtë kategori, duke u paraqitur në mënyrë të drejtpërdrejtë ose në lidhje me personalitete vendore dhe ndërkombëtare, veçanërisht në përmbajtje që lidhen me zhvillimet politike në Kosovë, kryesisht përmes deklaratave të rreme, të sajura ose të nxjerra jashtë kontekstit. Temat lidhen me qeverisjen e Kurtit, veriun e Kosovës, Gjykatën Speciale, marrëdhëniet me ndërkombëtarët dhe zhvillimet politike në vend.

jo tregon se gjatë gushtit, figurat politike dhe publike u përdorën kryesisht si pjesë e narrativave të manipuluar, veçanërisht përmes atribuimit të deklaratave që nuk janë bërë, keqinterpretimit të qëndrimeve të tyre ose paraqitjes së materialeve të falsifikuara si burime autentike.

Publikimet në gjuhën serbe dhe të tjera

Gjatë muajit gusht 2026, 5 përmbajtjet keqinformuese në gjuhën serbe u karakterizuan kryesisht nga pretendime të pabazuara dhe narrativa që lidhen me sigurinë, veriun e Kosovës dhe marrëdhëniet ndëretnike. Në disa raste, ngjarje reale u shoqëruan me interpretime të pakonfirmuara, duke krijuar një narrativë që paraqet serbët në Kosovë si të rrezikuar ose Kosovën si burim të kërcënimit. Përmbajtje të tilla u shpërndanë si në media online, ashtu edhe në rrjete sociale, përfshirë kanale në Telegram.

Një nga rastet më të spikatura lidhej me zjarrin e një shtëpie në Zveçan, ku u pretendua pa prova se familja Berisha e kishte djegur vetë shtëpinë për t'i fajësuar serbët dhe se ngjarja ishte orkestruar nga Albin Kurti. Po ashtu, një pretendim tjetër e paraqiste një pajisje të paidentifikuar si një “top zjarri” të lëshuar nga territori i Kosovës drejt Bërnjakut, duke e cilësuar rastin si “sulm terrorist”. Megjithatë, nuk u paraqitën prova për origjinën apo autorësinë e saj, ndërsa Policia e Kosovës mohoi se një pajisje e tillë ishte lëshuar nga territori i Kosovës.

Gjykata Speciale ishte një tjetër temë e përdorur për ndërtimin e narrativave alarmuese. RT Balkan pretendoi se gjykimi dhe një dënim i mundshëm i ish-krerëve të UÇK-së mund të shkaktonte një valë dhune ndaj serbëve në Kosovë, duke e krahasuar situatën me marsin e vitit 2004. Ky skenar u paraqit përmes parashikimeve për “hakmarrje” dhe “spastrim etnik”, pa u mbështetur në prova konkrete që do të dëshmonin një rrezik të tillë.

Ndërkohë, në përmbajtjet në gjuhën serbe u evidentuan edhe manipulime të raportimeve mediatike dhe lidhje të pabazuara me motive etnike. Portali serb “Vaseljenska.net” paraqiti si raportim të portalit suedez “Samnytt” një tekst që në fakt ishte opinion, duke krijuar përshtypjen e një raportimi të pavarur për arrestimin e personave serbë në Gazimestan. Në një rast tjetër, grabitja e një kishe në Bushincë të Kamenicës u paraqit nga Zyra për Kosovën në Qeverinë e Serbisë si incident me “motiv etnik”, ndonëse Policia e Kosovës nuk kishte përcaktuar autorët apo motivin dhe rasti ishte ende nën hetim. Këto raste tregojnë se gjatë gushtit, përmbajtjet në gjuhën serbe u fokusuan veçanërisht në sigurinë, incidentet në zonat me shumicë serbe dhe tensionet ndëretnike, shpesh duke shfrytëzuar ngjarje reale për të ndërtuar interpretime të pabazuara ose konspirative.

3. Narrativat ruso-serbe

Shtatë narrativat kryesore të identifikuara në përmbajtjet në gjuhën serbe u fokusuan në viktimizimin e serbëve në Kosovë, delegjitimimin e institucioneve të Kosovës dhe sulmet ndaj Perëndimit. Narrativa e parë lidhej me pretendimet e Aleksandar Vuçiqit për Kosovën, përmes të cilave Serbia paraqitet si viktimë e standardeve të dyfishta të Perëndimit, ndërsa përgjegjësia për moszbatimin e marrëveshjeve i atribuohet Kosovës.

Narrativa e dytë lidhej me optimizimin gradual të KFOR-it, i cili u paraqit si “braktisje” e serbëve dhe krijim i një vakumi sigurie në veri. Në këtë kuadër, u përpoq të delegjitimohej edhe Policia e Kosovës, duke e paraqitur si burim të pasigurisë dhe duke lidhur incidente të ndryshme me pretendimin për “terror sistematik” ndaj serbëve.

Narrativa e tretë kishte në qendër filmin kosovar “Dua”, i cili në disa media serbe u paraqit si projekt propagandistik që synon ta portretizojë Serbinë si pushtuese dhe shqiptarët vetëm si viktima. Kështu, një vepër artistike u interpretua përmes një kornize politike dhe etnike, duke i atribuar filmit qëllime propagandistike pa mbështetje të mjaftueshme faktike. Po, ashtu u pretendua se emri i filmitu përdor si formë e marketingut duke e ndërlidh me Dua Lipën dhe reputacionin që ajo ka.

Narrativa e katërt u ndërtua rreth Ibrit dhe Ujmanit si instrumente të luftës hibride, veçanërisht pas deklaratave të Vuçiqit për mundësinë e ndryshimit të rrjedhës së lumit Ibër. Zhvillimet në veri u paraqitën si pjesë e një konfrontimi më të gjerë politik, ndërsa çështjet e ujërave dhe infrastrukturës u shndërruan në elemente të diskursit konfliktual Kosovë–Serbi.

Narrativa e pestë lidhej me hapjen e urës së Ibrit, e cila u paraqit si kërcënim për sigurinë e serbëve dhe u lidh me ngjarjet e 17 marsit 2004. Përmes këtij paralelizmi, një zhvillim aktual u vendos në kornizën e traumës së vitit 2004, duke krijuar një perceptim të rrezikut të përsëritjes së dhunës.

Narrativa e gjashtë, e promovuar veçanërisht nga zyrtarë dhe media ruse, paraqiti pretendimin për “spastrim etnik” dhe “terror sistematik” ndaj serbëve në Kosovë. Në këtë narrativë, Kosova dhe institucionet e saj paraqiten si përgjegjëse, ndërsa KFOR-i, NATO-ja dhe BE-ja akuzohen për tolerim ose mbështetje të këtyre veprimeve. Rusia, në të kundërtën, pozicionohet si mbrojtëse e serbëve dhe e interesave të Serbisë.

Narrativa e shtatë konsistoi në intensifikimin e këtyre narrativave nga mediat dhe aktorët rusë, veçanërisht përmes RT Balkan, ku viktimizimi i serbëve, delegjitimimi i Perëndimit dhe fajësimi i Albin Kurtit dhe institucioneve të Kosovës u ndërthurën në një kornizë të vetme. Në këtë mënyrë, Kosova u përdor jo vetëm si temë e konfliktit Kosovë–Serbi, por edhe si argument për të sulmuar kredibilitetin dhe politikën e Perëndimit, ndërsa Beogradi dhe Moska paraqiten si aktorë që mbrojnë interesat e serbëve.

Metodologjia

Për hartimin e këtij raporti monitorues janë përdorur metodat kuantitative dhe ato kualitative.

Sa i përket metodave kuantitative, fillimisht është krijuar baza e të dhënave nga ADS/hibrid.info me qëllim të zbërthimit dhe analizimit të detajuar të trendëve të keqinformimit. Përmes kësaj baze të të dhënave, e cila mirëmbahet dhe përditësohet në baza të rregullta ditore nga stafi i ADS/hibrid.info, monitorohen rregullisht artikujt me përmbajtje keqinformuese.

Kjo nënkupton se të gjithë artikujt e publikuar në platformën hibrid.info vendosen në bazën e të dhënave dhe kjo e fundit shërben si një ndër burimet kryesore për përgatitjen e raportit monitorues. Për më tepër, metodologjia e përdorur për analizimin e të dhënave të paraqitura në raportin monitorues bën të mundur filtrimin e të dhënave në baza ditore, javore e mujore, dhe atë në formë kryesisht kuantitative, për të kuptuar më qartë fenomenin e keqinformimit të atyre artikujve të analizuar për këtë periudhë monitoruese një mujore sipas kategorive e vlerësimeve të ndryshme.

Krahas kësaj, një burim tjetër i rëndësishëm për këtë raport është metodologjia e ADS/hibrid.info (e publikuar në faqen e hibrid.info) për luftën kundër çrregullimit informativ. Metodologjia, e cila është e bazuar para së gjithash në metodat kualitative, është hartuar nga stafi profesional i ADS/hibrid.info dhe është në harmoni me standardet më të larta ndërkombëtare për kontroll të fakteve, gjegjësisht sipas udhëzimeve të Rrjetit Ndërkombëtar për Kontroll të Fakteve (IFCN). ADS/hibrid.info është anëtarë me të drejta të plota në këtë mekanizëm ndërkombëtar – IFCN.

Ky raport monitorues përfshin periudhën nga 1 deri më 31 gusht 2026, në të cilën janë trajtuar 40 përmbajtje keqinformuese.

Ky raport i shkurtër monitorues paraqet një pasqyrë të gjendjes njëmuajore të informimit (keqinformimit) gjatë muajit gusht 2026, nga të dhënat e platformës për kontroll të fakteve – hibrid.info.

Gjatë muajit gusht 2026, keqinformimi u karakterizua nga dominimi i lajmeve të rreme (37%), të pasuara nga manipulimi i fakteve (20%) dhe clickbait-i (17%), ndërsa përmbajtjet e paverifikuara dhe mashtrimet përbënin nga 11% secila dhe dezinformatat 3%. Për sa i përket tematikave, dominuan deklaratat e rreme (31%), Gjykata Speciale (9%) dhe shtesat për fëmijë (6%), ndërsa temat e tjera, përfshirë zgjedhjet, zhvillimet në veri, energjinë, pensionet, Urën e Ibrit, incidentet dhe çështjet rajonale, u shfaqën me nga 3%. Në aspektin e fushave, politika ishte dukshëm dominuese me 69%, e ndjekur nga fusha sociale me 9%, siguria dhe drejtësia me nga 6%, ndërsa kronika e zezë, energjetika, komunikacioni dhe siguria kibernetike përbënin nga 3%.

Përhapja e keqinformimit gjatë gushtit u zhvendos fuqishëm drejt mediave sociale, të cilat përbënin 94% të rasteve, krahasuar me vetëm 6% të rasteve të publikuara në media. Facebook-u ishte platforma dominuese me 88%, ndërsa TikTok-u përbënte 9% dhe platformat e tjera 3%. Brenda Facebook-ut, përmbajtjet u publikuan kryesisht nga fan pages, llogari individuale dhe faqe të identifikuara si media. Kjo tregon se rrjetet sociale, veçanërisht Facebook-u, mbetën kanali kryesor për qarkullimin dhe amplifikimin e përmbajtjeve keqinformuese gjatë këtij muaji.

Sa i përket aktorëve të përfolur, institucionet dhe subjektet publike u përfshinë në tri raste, ku KEDS-i, LVV-PDK-LDK-AAK dhe Qeveria përbënin nga 33% secili. Pretendimet lidhen me reduktimet e energjisë, një sondazh të pakredibil politik dhe keqinterpretimin e një tenderi për automjete. Ndërkohë, personalitetet publike u përfshinë në 22 përmbajtje keqinformuese, me Albin Kurtin si figurën më të përfolur, i cili u shfaq në mënyrë të drejtpërdrejtë në 14% të rasteve dhe në kombinim me figura të tjera politike e publike në raste të shumta. Këto përmbajtje përfshinin deklaratat e rreme, citime të sajura, manipulime të deklaratave dhe pretendime të pabazuara që lidhnin Kurtin me personalitete vendore dhe ndërkombëtare.

Përmbajtjet keqinformuese në gjuhën serbe u fokusuan kryesisht në sigurinë, veriun e Kosovës dhe marrëdhëniet ndëretnike, duke përdorur ngjarje reale për të ndërtuar pretendime të pabazuara dhe narrativa alarmuese që i paraqesin serbët si të rrezikuar dhe Kosovën si burim kërcënimi. Ndër rastet kryesore ishin pretendimet se familja Berisha kishte djegur vetë shtëpinë në Zveçan për të fajësuar serbët, se një “top zjarri” ishte lëshuar nga Kosova drejt Bërnjakut, si dhe narrativa se gjykimi i ish-krerëve të UÇK-së mund të shkaktonte dhunë ndaj serbëve, të krahasueshme me marsin e vitit 2004. Paralelisht, u evidentuan manipulime të raportimeve mediatike dhe atribuime të pabazuara të motiveve etnike, si në rastin e grabitjes së një kishe në Kamenicë. Këto përmbajtje u shpërndanë si në media online dhe rrjete sociale, përfshirë Telegramin, ndërsa në një nivel më të gjerë u amplifikuan narrativa që synojnë delegjitimimin e institucioneve të Kosovës dhe pranisë ndërkombëtare, duke paraqitur KFOR-in, NATO-n dhe Perëndimin si faktorë që rrezikojnë komunitetin serb.

Narrativat kryesore në gjuhën serbe u përqendruan në viktimizimin e serbëve në Kosovë, delegjitimimin e institucioneve të Kosovës dhe diskreditimin e Perëndimit. Në këtë kuadër, u promovuan pretendime se optimizimi i KFOR-it dhe hapja e urës së Ibrit përbëjnë rrezik për serbët, duke i lidhur zhvillimet aktuale me ngjarjet e marsit 2004; Ibri dhe Ujmani u paraqitën si instrumente të përshkallëzimit të konfliktit; ndërsa filmi “Dua” u interpretua si propagandë kundër Serbisë. Paralelisht, Vuçiqi dhe mediat serbe e ruse amplifikuan narrativa për “spastrim etnik”, “terror sistematik” dhe standarde të dyfishta të Perëndimit, duke fajësuar Kosovën, KFOR-in, NATO-n dhe BE-në, ndërsa Rusia dhe Serbia paraqiten si mbrojtëse të komunitetit serb dhe interesave të tij.

HIBRID.INFO